



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCEVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
SHKOLLA TEKNIKE ELEKTRIKE "GJERGJ CANCO"

Nr. 29/ prot.

Tiranë, më 16.10.2023

Lënda: Njoftim për vend të lirë.

DREJTORISË SË SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
DREJTORISË SË MARËDHËNIEVE ME PUBLIKUN
AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

Në zbatim të ligjit nr. 15/2019, "Për nxitjen e punësimit"; të ligjit nr. 15/2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë"; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 554, datë 31.7.2019, "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë Kombëtare të punësimit dhe aftësive"; të udhëzimit nr.14, datë 27.5.2021, "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesëve publikë të arsimit dhe formimit profesional",

Shkolla Teknike Elektrike "Gjergj Canco" Tiranë, ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionin:

-1 (një) mësimdhënës i teorisë profesionale të drejtimit Elektroteknik.(me kohë të pjesshme)

- Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme si vijon:

- a. të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b. të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c. të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d. të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e. të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- f. të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit.

Aplikanti për mësimdhënës të teorisë profesionale duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

- a. të ketë diplomë të nivelit master profesional ose të barasvlershme, në të njëjtën fushë me kualifikimin profesional të kërkuar;
- b. Të ketë të paktën 1 (një) vit përvojë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet;
- c. Të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit;

Dokumentet e aplikimit

- Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:
 - a. letërmotivimin për pozicionin;
 - b. jetëshkrimin (CV-në);
 - c. kartën e identitetit;
 - d. diplomën;
 - e. librezën e punës;
 - f. cdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
 - g. cctifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
 - h. vërtetimin e gjendjes shëndetësore;
 - i. vërtetimin e gjendjes gjyqësore;
 - j. vërtetimin nga punëdhënësi i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi
 - k. të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënës të mëparshëm.
- Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopjo të noterizuara të tyre. Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuara.
- Dokumentet e aplikimit dorëzohen në zyrën e protokollit të shkollës, brenda datës 24.10.2023.2023

DREJTORE

Hedie Gjoni

